

KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Sot më datë, 08/10/2022 (dymije e njëzetedy), lidhet kjo kontratë Shitblerje Kuote (në vijim referuar edhe si “Kontrata”), midis palëve të paraqitura si në vijim:

- **Z. Hasan OTVES**, shtetas shqiptare, lindur në Tiranë (Shqipëri) më 21.08.1992 dhe me vendbanim në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës identiteti nr. 032555111, me Numer Personal J20821037K (në vijim referuar edhe si “**Pala Shitëse**”);
- **Z. Shyqyri TOMORRI**, shtetas shqiptare, lindur në Strum (Shqipëri) më 07.07.1980 dhe me vendbanim në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës identiteti nr.034996083, me Numer Personal I00707210I (në vijim referuar edhe si “**Pala Shitëse**”);

dhe

- “**TEKNO FIRE**” SHPK, shoqëri tregtare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar të Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L01307010S , e përfaqësuar nga administratori Z. Gramoz Çejku, lindur në Kukës më 20.04.1988, dhe me vendbanim në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes me nr. BA9863003 dhe me Numer Personal I80420143C, (në vijim referuar edhe si “**Pala Blerëse**”);

Kushtet paraprake

- Pala shitëse Z. Hasan Otves dhe Z. Shyqyri Tomorri, është pronare e dy kuotave të barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar (në vijim referuar edhe si “**Kuota**”) të shoqërisë të së drejtës shqiptare “**Tekno Vision**”, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në regjistrin tregtar të Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L91528015R, me seli në Rruga e Elbasanit, perballe Fakultetit Histori- Filologjise, Park Gate, kati 8, apartamenti 59, Tiranë, Shqipëri (në vijim referuar edhe si “**Shoqëria**”);
- Pala Shitëse dëshiron të shesë Kuotën Shoqërisë “Tekno Fire” shpk sipas vendimit të asamblesë datë 04.10.2022;
- Pala Shitëse dëshiron ti shesë Kuotën Palës Blerëse dhe Pala Blerëse dëshiron të blejë Kuotën nga Pala Shitëse, sipas kushteve dhe afatve të përcaktuara në vjim.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, bien dakord si në vijim:

Neni 1

Kushtet paraprake

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

Neni 2

Shitja e Kuotës

2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Pala Shitëse i shet dhe transferon Palës Blerëse, e cila pranon dhe blen Kuotën, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.

2.2. Titulli i pronësisë të Kuotës nga Pala Shitëse tek Pala Blerëse transferohet me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

2.3. Pala Blerëse, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Palës Shitëse, dhe si ortak i Shoqërisë merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme të Shoqërisë në proporcion me Kuotën e tij duke filluar nga data e kësaj Kontrate.

2.4 Me transferimin sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë si më poshtë: Shoqëria "Tekno Fire" shpk do të zotërojë një kuotë të barabartë me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Tekno Vision" shpk

Neni 3

Çmimi

3.1 Transferimi i Kuotës parashikuar në nenin 2.1 më sipër kryhet dhe pranohet për çmimin e rënë dakord nga Palët i cili përkon me vlerën nominale të Kuotës, i barabartë me ALL 100.000 (njëqind mijë lekë), (në vijim referuar si "Çmimi").

3.2 Palët pranojnë se Çmimi është paguar me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci të Palëve

4.1 Pala Shitëse garanton Palën Blerëse së është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër, në emër të tij, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.

4.2 Pala Shitëse garanton Palën Blerëse se Kuota objekt e kësaj kontrate është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, detyrim, apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.

4.3 Pala Blerëse deklaron se hyn në Shoqëri, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet. Në fakt, Pala Blerëse deklaron se pranon plotësisht situatën financiare të Shoqërisë që rezulton deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

4.4 Në përputhje me dispozitat e pikës 4.3, më sipër, Pala Blerëse pranon shprehimisht dhe pa asnjë rezervë të blejë Kuotën.

Neni 5

Shpenzimet

5.1 Shpenzimet ligjore dhe kontabël, shpenzimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me regjistrimin e kësaj Kontrate, do të jenë në ngarkim të Palës Blerëse.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve me diskutim të drejtpërdrejtë midis tyre.

6.2 Nëse nuk arrihet që mosmarrëveshja të zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhja do t'i besohet eskuzivisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

Neni 7

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

Neni 8

Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e Kuotës nga Shitësi tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me të njëjtin objekt. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga të gjitha Palët.


2

Neni 9
Origjinalet


Kjo Kontratë është lidhur në 4(katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të tëra të nënshkuara nga Palët.

Unë, Noteri ia lexova këtë Kontratë Palëve, të cilat në prani të përkthyeses, e deklaruan atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Kjo Kontratë nënshkruhet nga Palët në praninë time, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas Ligjit.


SHITËSI


Z. HASAN OTVES




Z. SHYQYRI TOMORRI

BLERËSI


TEKNO FIRE shpk

